



# Republika e Kosovës

## Kuvendi Komunës së Malishevës



Kryetari i Komunës

**Nr. 01/\_\_\_**

Datë: 22/01/2019

Në mbështetje të nenit 68 paragrafi 3 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr: 28, nenit 12 dhe 22 të Rregullores së MF, nr: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Malishevës në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës, bëjnë:

### **THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM**

Ftohen organizatat joqeveritare të sferës së shërbimeve publike sociale dhe familjare, që janë aktive dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre në Komunën e Malishevës, se mund të aplikojnë me projektet e tyre për përkrahje financiare nga Komuna e Malishevës për vitin 2019 .

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

1. Projekt-propozimi,
2. Aplikacioni,
3. Dokumenti identifikues,
4. Licencë për personat juridik,
5. Certifikata e regjistrimit (për personat juridik),
6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik),
7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik),
8. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit,

Komuna e Malishevës, do të ndajë mjete financiare për shërbime shëndetësore shtëpiake.

Shërbimet të cilat ofrohen sipas kësaj thirrje publike, përfshinë;

1. Përkujdesje shtëpiake, vizita shtëpiake,
2. Transporti i pacientëve me regjim-dialize,
3. Transporti i pacientëve me aftësi të kufizuar,
4. Pajisje për personat me aftësi të kufizuar.

Ofruesi i shërbimeve duhet të jetë i licencuar nga organet kompetente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve të lartcekura.

Mbështetje financiare do të ofrohet varësisht nga vlerësimi i projektit nga Komisioni dhe mundësitë buxhetore të komunës.

Tërheqja dhe dorëzimi i aplikacionit mund të bëhet në ndërtesën e Komunës, kati i parë, në Qendrën për Shërbime për Qytetarët.

Aplikacionet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarf të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar.

Aplikuesit mund ta dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit prej 15 ditë pune nga dita e shpalljes në ueb faqen e komunës, tabelën e shpalljeve të KK-Malishevës.

**Kryetari i Komunës**  
**Ragip Begaj**

---